



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 062/25
Data: 15.01.25

Prishtinë, 30 dhjetor 2025
Kodi i ZRRE-së: V_3016_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 25, Nenin 26 par. 1 nën par. 1.2, Nenin 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e Nenit 18 dhe nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike;
- Vendimin për NQ Gjakova SH.A., Nr. V_3015_2025 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR); dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Tarifave të Energjisë Termike, të dorëzuar me datë 23 korrik 2025, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Termike me dokumentacionin relevant sqarues;

në seancën e mbajtur me datë 30 dhjetor 2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN** tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë të Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova SH.A.
- II.** Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova sh.a., është dhënë në tabelën 1 më poshtë:

Tabela 1: Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova SH.A. – sezoni 2025/2026:

TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE TË NQ GJAKOVA - Sezoni 2025/2026			
A: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE ME MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.86	
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variabile)	[€/MWh]	51.18	
B: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE PA MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m ² për muaj]	0.12	0.17
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variabile)	[€/m ² për muaj]	0.73	1.02
Tarifa totale për konsumatorët pa matje	[€/m ² për muaj]	0.85	1.19



- III. Duke marrë parasysh gjendjen aktuale lidhur me matjen e furnizimit/konsumit të energjisë termike, **tarifat e përcaktuara në dispozitivin nën pikën II. të këtij Vendimi zbatohen për faturim për rastet tipike si në vijim:**
1. Për objektet, nënstacionet e të cilëve janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike, dhe që janë në pronësi ose në shfrytëzim të një konsumatori, për faturim zbatohen tarifat me matje – Tabela 1.A
 2. Për objektet e banimit kolektiv që janë në pronësi ose në shfrytëzim të disa konsumatorëve, nënstacionet e të cilëve janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike dhe ku është funksionale matja e konsumit në nivel apartamenti, për faturim zbatohen tarifat me matje – Tabela 1A; të njëjtat tarifa zbatohen edhe për konsumin e përbashkët sipas metodologjisë së përshkruar në Ankesin 8 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike.
 3. Për objektet, nënstacionet e të cilëve nuk janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike dhe për objektet e përshkruara nën pikën (2) në të cilat nuk ekziston ose nuk është funksionale matja në nivel apartamenti, për faturim do të zbatohen tarifat “normative”, sipas sipërfaqes ngrohëse të konsumatorit, – Tabela 1B.
- IV. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike të ZRRE-së, NQ Gjakova sh.a. duhet ta publikoj strukturën e tarifave të energjisë termike, siç është përcaktuar në tabelën 1 të këtij Vendimi, në faqen e saj elektronike dhe në së paku një prej mediave me shpirtirje më të gjerë në Kosovë.
- V. Ky vendim do të zbatohet nga ndërmarrja NQ Gjakova SH.A., duke filluar nga data e aprovimit deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 23 korrik 2025 nga NQ Gjakova SH. A., ka pranuar aplikacionin/kërkesën për shqyrtimin dhe aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe tarifave të energjisë termike.
- ZRRE me rastin e përcaktimit të tarifave të energjisë termike, ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:
 - Të dhënat dhe informatat e dorëzuara bashkangjitur me kërkesën për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe tarifave, të datës 13 korrik 2025;
 - Komentet me shkrim lëshuar nga ZRRE me 12 gusht 2025, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të të dhënave dhe informatave të dorëzuara bashkangjitur;
 - Të dhënat dhe informatat e korrigjuara dhe të plotësuara sipas komenteve me shkrim të ZRRE-së, ri-dorëzuar nga NQ Gjakova SH.A. me datë 22 gusht 2025;
 - Raportin për Konsultim Publik: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Gjakova SH.A.– sezoni i ngrohjes 2025/2026;
 - Gjatë periudhës së konsultimit publik (29 tetor – 12 nëntor 2025) ZRRE nuk pranuar ndonjë koment për raportin në fjalë;
 - Raportin Final për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Gjakova SH.A. – sezoni i ngrohjes 2025/2026.




- Raportin final për Përcaktimin e Tarifave të Energjisë Termike për NQ Gjakova SH.A. – sezoni i ngrohjes 2025/2026.
- Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Prehiqi, Anëtar

Bashkangjitur: Raporti Rregullativ: Përcaktimi i tarifave për NQ Gjakova sh.a. – sezoni i ngrohjes 2025/2026

Vendimi iu dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së